

Bismilahirr-rrahmanirr-rrahim

Përktimi i

Fjalimit të Xhumasë

të Kalifit të V-të të Xhematit Islamik Ahmedia,

Hazret Mirza Masrur Ahmedit

mbajtur në Kanada më

25 Qershor 2004

Udhëtimi

Njeriu udhëton në botë me qëllime të ndryshme. Në ditët tona, falë mjeteve bashkëkohore të transportit, udhëtimi është bërë i lehtë dhe i shpejtë, dhe për shkak të këtyre mjeteve, distancat duket se janë shkurtuar. Në kohët e shkuara, udhëtimi prej njëzetë-tridhjetë kilometrave konsiderohej udhëtim i gjatë, ndërsa në ditët tona një distancë e tillë nuk konsiderohet më si udhëtim. Qoftë në udhëtim biznesi apo për t'u takuar me njerëz, për kërkime të ndryshme ose për studime, për qëllime fetare ose për ndonjë aktivitet tjetër shoqëror, besimtari duhet gjithnjë të jetë i kujdesshëm, që gjatë udhëtimeve të tij, kurrë të mos ketë ndonjë moment, pa marrë parasysh vështirësitë, që zemra e tij të jetë e zbrazët nga **takva** – dashuria dhe frika e Allahut. Shumica prej jush që sot jeni prezent këtu, keni qenë të shtrënguar të emigroni nga Pakistani dhe keni shpenzuar shumë për ta bërë këtë udhëtim, madje disa kanë shpenzuar gjithçka që kishit për të arritur këtu. Shumica prej jush, në fillim keni vuajtur shumë, pastaj Allahu gradualisht i ka përmirësuar kushtet tuaja. Ndaj një pjese prej jush, qeveria është treguar zemërgjerë dhe u ka dhënë edhe nënshtetësinë kanadeze.

Për shumicën prej jush ky udhëtim është dëshmuar i suksesshëm në fund. Gjatë procedurës së azilkërkuesit, kur qëndrimi juaj në këtë vend ishte i pasigurt, ju i luteshit Allahut me përulje dhe kërkonit edhe prej të tjerëve të luteshin për ju. Ju ishit të shqetësuar dhe kishit frikë. Tani që Allahu ju ka dhënë kaq shumë të mira materiale, nuk duhet të ndodhë që këto të mira materiale të ju largojnë prej Tij. Nëse kjo do të ndodhte, atëherë, mbani mend se ai Zot i cili ju ka dhënë të gjitha këto të mira, ka gjithashtu fuqi t'ua marrë ato.

Ahmedianët kanë nderin që për hir të Allahut, të udhëtojnë shpesh. Ata shpesh udhëtojnë për të marrë pjesë në tubimet e tyre fetare dhe këtë e bëjnë me vullnet të madh. Sot, shumica prej jush, keni ardhur këtu për këtë qëllim. Disa kanë ardhur nga qytete të largëta të Kanadasë, disa nga SHBA-të dhe vende të tjera, vetëm për të marrë pjesë në konferencën tuaj vjetore që do të mbahet javën e ardhshme. Ky udhëtim duhet të bëhet vetëm për hir të Allahut. Fitimi i afërsisë së Allahut duhet gjithmonë të jetë qëllimi juaj i vetëm. Në tubime të tilla zemrat tuaja duhet të jenë të lira nga çdo ligësi. Për hir të mirëvajtjes së konferencës vjetore, ju gjatë këtyre ditëve, duhet ta frenoni veten tuaj nga çdo

zënkë ose grindje. Për hir të Allahut, ju duhet t'ua qëndroni larg grindjeve, përqeshjeve, talljeve dhe nuk duhet të rri në shoqëri me ata që tallen ose i përgojnë të tjerët. Gjithashtu nuk duhet të rri me ata që e kalojnë kohën kot në biseda të pavlera, ose rri në natën deri vonë pa asnjë arsye, e pastaj as nuk mund të ngrihen të nesërmen për namazin e mëngjesit. Qëndrimi në ato ndeja të kota, i vë ndryshk zemrës suaj. Pra, ju assesi nuk duhet të bëheni pjesë e atyre ndejeve, madje duhet të mundoheni t'ua shpjegoni të tillëve që të mos e harxhojnë kohën e tyre në këtë mënyrë. Ndejat dhe bisedat e kota e zbrazin zemrën tuaj nga takva (dashuria dhe frika e Allahut) dhe ju largojnë nga Allahu i Madhërishëm. Myslimani nuk guxon të lejojë për asnjë moment që zemra e tij të jetë e zbrazët nga takva dhe përkujtimi i Allahut. Mbani mend, se kur njeriu e lë anash takvën dhe përkujtimin e Allahut asgjë nuk shkon mbarë.

Pra, posaçërisht në ato udhëtime që ndërmerren për hir të Allahut, ju duhet të jeni shumë të kujdesshëm ndaj takvës. Allahu i Madhërishëm, duke folur në Kuranin e Shenjtë për Haxhin, ka thënë se furnizimi më i mirë që ju mund ta merrni me vete është **takva**. Kjo do thotë se, në çdo udhëtim që e ndërmerrini për hir të Allahut, duhet të jeni shumë të vëmendshëm ndaj takvës. Në këtë mënyrë ju do të jeni në gjendje ta reformoni veten tuaj dhe t'i afroheni gjithnjë e më shumë Allahut të Madhërishëm dhe do ta kuptoni gjithnjë e më mirë Allahun-^{xhsh}. Po ashtu edhe marrëdhëniet tuaja me njerëzit do të përmirësohen dhe dashuria ndaj tyre do të rritet dhe me këtë, shoqëria juaj do të jetë e denjë për t'ua quajtur "shoqëri e përkryer".

Mbani mend se ngatërresat në botë ngrenë kokë, kur njeriu, në vend që të mbështetet në Allahun^{xhh}, mbështetet në qeniet njerëzore. Ata shpresojnë nga njerëzit në vend që të shpresojnë në Allahun^{xhh}. Nëse kjo ndjenjë është prezentë te njerëzit, në mes nikoqirit dhe mysafirit do të ketë pakënaqësi. Disa njerëz janë tepër të ndjeshëm dhe u mbetet hatri për gjëra të imëta dhe kultivojnë keqdashje ndaj të tjerëve. Kjo, në fakt shkaktohet vetëm nga mungesa e takvës dhe nga asgjë tjetër. Njerëzit e urtë, kur vijnë në tubime të mëdha të Xhematit, sjellin me vete tenda, e disa madje sjellin me vete edhe shtëpizat rimorkio. Kjo është një praktikë e mirë. Kjo u mundëson atyre që të qëndrojnë pa krijuar asnjë problem për të tjerët. Administrata e Xhematit duhet të sigurojë hapësirat e nevojshme për ata që dëshirojnë të kampanjë. Në Evropë kjo është një praktikë e mirë. Pastaj, sa i përket përgatitjes dhe servimit të ushqimit, kjo është detyrë e nikoqirëve që të kujdesen për nevojat e mysafirëve që vijnë si mysafirë të Mesihut të Premtuar^{as}.

Por, tani t'i kthehemi përsëri temës së udhëtimeve. Udhëtimet kanë vështirësitë e veta me gjithë lehtësimet që janë krijuar në kohët tona. Udhëtari gjithmonë duhet t'i lutet Allahut që ta bëjë udhëtimin e tij sa më të lehtë dhe që ai të përfundojë mirë.

Hazret Anasi^{ra} transmeton se një herë, një njeri erdhi te Profeti i Shenjtë^{sas} dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut! Po bëhem gati të nisem në një udhëtim. Më jep ndonjë furnizim me vete". Profeti u lut për të: "Allahu të furnizoftë gjatë këtij udhëtimi". Ai pastaj i tha: "Më jep edhe diçka më shumë me vete". Profeti u lut: "Allahu t'i faltë mëkatet tuaja". Ai ende nuk ishte i kënaqur dhe kërkoi edhe më shumë. Atëherë Profeti u lut: "Allahu të dhëntë të mirat e Tij, kudo që të ndodhesh".

Posaçërisht gjatë udhëtimeve tuaja, ju duhet të luteni: *"O Allah! Takva mund të fitohet vetëm nga Mirësia Juaj, pra, mos më lejo të mbështetem në njerëzit e tjerë dhe të shpresoj prej tyre, e pastaj të ndahem i pakënaqur me ta. Jepmi bekimet Tuaja nga Vetja Juaj"*. Kjo lutje është e ngjashme me lutjen Hazret Musait^{as}: **"Rabbi inni lima anzalta ileija min khairin fakir"**, që do të thotë: *"O Zoti im, unë jam lypës në pragun Tënd, dhe kam nevojë për çfarëdo të mire që të më dhurosh."*

Transmetohet nga Hazret Ebu Hureira^{ra} se njëherë një njeri erdhi te i Dërguari i Allahut^{sas} dhe i tha atij: *"O i Dërguari i Allahut! Më këshillo, se po përgatitem për një udhëtim"*. Profeti i tha: *"Merre me vete takvën (dashurinë dhe frikën e Allahut). Sa herë që të ngjitesh në ndonjë përpjetës, thuaj: Allahu Ekber"*. Dhe kur ai po nisej për në atë udhëtim, i Dërguari i Allahut^{sas} u lut për të: *"O Allah! Bëje udhëtimin e tij të lehtë dhe të këndshëm për të!"*

Profeti i shenjtë^{sas} na e ka mësuar mënyrën se si duhet të veprojmë gjatë udhëtimit. E para është, që të fillojmë udhëtimin me lutje. Kur të hipim në çfarëdo mjeti transportues, ai na ka mësuar që të lutemi: *"I shenjtë është Ai i cili na e ka nënshtruar këtë mjet transporti. Ne nuk do të mund ta kishim nënshtruar këtë mjet transporti me fuqinë tonë. Dhe te Zoti ynë ne do të kthehemi"*.

Ka edhe lutje të tjera si: *"O Allah! Po kërkojmë mirësinë e këtij udhëtimi. Bëje këtë udhëtim të këndshëm për ne. O Allah! Bëhu shoqëruesi ynë në këtë udhëtim dhe kujdesu për ata që po lëmë pas. O Allah! Po kërkojmë mbrojtjen Tënde prej vuajtjeve dhe vështirësive të këtij udhëtimi, prej gjërave jo të mira, prej humbjes ose dëmtimit dhe prej gjithçka që nuk na pëlqen"*.

Kur Profeti i Shenjtë^{sas} kthehej nga udhëtimi, ai thoshte: *"Po kthehem duke kërkuar falje prej Allahut. Ne jemi robër të devotshëm të Allahut dhe e lavdërojmë Zotin tonë"*.

Në kohën e Profetit^{sas}, njerëzit udhëtonin me deve dhe kuaj, ndërsa në kohën tonë, Allahu e mësoi njeriun si të ndërtojë mjetet moderne të transportit që sot i kemi në dispozicion. Kjo dituri ka ardhur nga Allahu i Madhërishëm dhe ne duhet të jemi shumë mirënjohës ndaj Tij. Gjatë udhëtimit, në vend të përgojimeve ose bisedave të kota, përkujtojeni Allahun dhe kërkonit prej Tij mirësitë e Tij, ndihmën e Tij dhe mbrojtjen e Tij nga të gjitha aksidentet e mundshme. Ju nuk duhet të jeni si ai që mendon se vetura e tij është nga modelet më të reja dhe mund t'i besohet njëqind për qind. Ju kurrë nuk duhet të mbështeteni në veturat tuaja të "sigurta", sepse nganjëherë, mjafton të jetë vetëm një vidë jo mirë e shtrënguar, apo shoferin ta mashtrorë gjumi ose ndonjë shofer tjetër i dehur ta zë rrugën dhe gjithçka përfundon si mos më keq. Pra, besimtari nuk e hedh asnjë hap pa kërkuar ndihmën dhe mëshirën e Allahut. Gjatë rrugës dhe të keni arritur në destinacionin tuaj, duhet gjithashtu të luteni për anëtarët tjerë të familjes ose për pasurinë që keni lënë pas. Ka ndodhur që kur e tërë familja është larguar për një kohë nga shtëpia, kur janë kthyer e kanë gjetur shtëpinë shkrumb e hi. Pra, gjithçka mund të ndodhë dhe asgjë nuk është e sigurt. Besimtari kurrë nuk kalon asnjë moment pa e kërkuar ndihmën dhe mëshirën e Allahut të Madhërishëm. Nganjëherë, gjatë udhëtimit ndodhë të shihni pamje të aksidenteve të tmerrshme dhe pastaj ato pamje ju ndjekin dhe ju shqetësojnë për një kohë të gjatë.

Profeti i Shenjtë^{sas} lutej vetë dhe na ka këshilluar edhe neve që kur të jemi në udhëtim, të lutemi vazhdimisht dhe kur të kthehemi në shtëpi të shprehim mirënjohjen tonë ndaj Allahut dhe të kërkojmë falje prej Tij si dhe të fokusohemi në adhurimin e Allahut në mënyrë që Allahu të na mbajë nën mëshirën e Tij.

Transmetohet nga H. Ebu Saidi^{ra} se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë se: *"Kur tre njerëz udhëtojnë së bashku, ata duhet ta caktojnë njërin nga mesi i tyre si udhëheqës."* Pra, kur njerëzit nisen në ndonjë udhëtim duhet ta caktojnë njërin prej tyre si udhëheqës. Pastaj, bashkudhëtarët mund t'i japin këshilla dhe sugjerime udhëheqësit të grupit. Nëse ai nuk bën diçka që është kundër principeve Islamike, ata duhet t'i binden atij. Për ta zhvilluar frymën e dëgjueshmërisë në fëmijët tuaj, kur të filloni ndonjë udhëtim me familjet tuaja, atëherë babai, ose ai i cili është zgjedhur si udhëheqës i grupit, duhet t'u thotë fëmijëve që unë jam udhëheqësi i grupit, sepse Profeti ka porositur që njëri të jetë udhëheqës, (amir) dhe ju duhet të jeni të dëgjueshëm ndaj udhëheqësit. Nëse do t'i edukoni fëmijët tuaj në këtë mënyrë, ata gjithashtu do të mësohen të bëhen të dëgjueshëm ndaj administratës së Xhematit.

Hazret Ka'ab bin Malik^{ra} transmeton se kur Profeti i shenjtë^{sas} kthehej nga udhëtimi, ai së pari hynte në xhami dhe i falte dy rekate të namazit vullnetar (navafil). Ka shumë të atillë që kur kthehen nga udhëtimi madje harrojnë t'i kryejnë edhe namazet e tyre të obligueshme, ose i vonojnë jashtë mase, dhe justifikimi i tyre është "lodhja". Ata harrojnë se udhëtimet e ditëve tona janë shumë më të rehatshme, krahasuar me udhëtimet e së kaluarës. Allahu na ndihmoftë ta mposhtim përtacinë.

Hazret Ebu Hurreira transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut^{sas} duke thënë se: *"Udhëtimi është i mundimshëm, sepse rutina e ushqimit, gjumit etj., çrregullohen. Pra, udhëtari, duhet ta përfundoj udhëtimin e tij sa më shpejtë që është e mundur"*.

Në ditët tona udhëtimi është bërë shumë më i lehtë dhe shumë më i rehatshëm. Ne udhëtojmë me aeroplanë, vetura, trena, etj., dhe brenda një kohe të shkurtër kalojmë distanca të gjata. Me gjithë këtë, për shkak se privohemi nga rutina e përditshme nëpër shtëpitë dhe vendbanimet tona, ne hasim në vështirësi të ndryshme. Ushqimi, gjumi dhe namazet, të gjitha këto çrregullohen gjatë udhëtimit.

Hazret Khaula bin Hakim^{ra}, transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut^{sas} duke thënë: *"Kur udhëtari ndalet, nëse lutet duke thënë: "Unë kërkoj mbrojtjen e Allahut nga çdo e keqe". Allahu do ta mbrojë atë dhe asnjë e keqe nuk do ta prekë atë njeri gjatë atij udhëtimit"*. Pra, këtu Profeti^{sas} i ka siguruar të gjithë ata që luten në këtë mënyrë se Allahu do t'i mbrojë. Pra, mundohuni ta mbani mend këtë lutje dhe ta përdorni gjatë udhëtimeve tuaja. Allahu e mbrojtë secilin prej nesh.

H. Abdullah bin Umer^{ra}, transmeton se kur i Dërguari i Allahut^{sas}, nisej natën në ndonjë udhëtim ai lutej: *"O tokë, Zoti yt dhe Zoti im është Allahu. Kërkoj*

mbrojtjen e Allahut nga çfarëdo e keqe që ka në ty, mbi ty ose rreth teje, dhe e kërkoj mbrojtjen e Allahut nga luanët, gjarpërinjtë dhe çdo insekt helmues". Është mësimi i Hazret Muhamedit^{sas}, që ta mbrojmë veten tonë nga çdo gjë negative e çfarëdo natyre qoftë ajo. Ju nuk duhet ta lejoni asnjë element negativ të ndikoj në ju. Disa njerëz absorbojnë elemente negative nga kulturat e ndryshme. Nëse do ta bëni këtë, atëherë, mund ta humbni identitetin tuaj. Natyrisht se është mirë të merrni dhe të përvetësoni çdo të mirë me të cilën vini në kontakt - madje kjo është e detyrueshme për çdo mysliman - por ka edhe ligësi dhe aspekte negative përreth jush të cilat mundohen të ju imponohen. Ju vetëm atëherë mund të gjykoni se çka është mirë dhe çka jo, nëse e dini se cili është mësimi i fesë tuaj. Pra, ju duhet të fokusoheni në mësimin e këtyre gjërave.

Hazuri më tutje tha se kur të udhëtoni, mundohuni ta bëni këtë gjatë ditës, ose nëse kjo nuk është e mundur atëherë flini mirë para se të udhëtoni natën. Në një hadith tjetër transmetohet se kur Profeti dërgonte ndonjë ekspeditë ushtarake, ai lutej: *"O Allah! Bekoji udhëtimet e umetit tim"*.

Hazret Safer^{ra} transmeton se kur Profeti i shenjtë dërgonte ndonjë ekspeditë, ai e niste atë herët në mëngjes. Vetë transmetuesi ishte tregtar dhe thoshte se edhe ai vetë filloi ta praktikonte një gjë të tillë dhe kishte përfituar shumë nga ajo praktikë. Pra, edhe ju duhet ta adoptoni një praktikë të tillë. Gjithnjë duhet ta mbani mend se bekimet e Allahut mund të fitohen vetëm nëse qëllimet tuaja janë të mira dhe të singërta. Kur të niseni në ndonjë udhëtim, qëllimi juaj duhet të jetë që adhurimi i Allahut dhe fitimi i kënaqësisë së Tij të kenë gjithmonë prioritet. Nëse udhëtimet tuaja tregtare fillojnë me këto mendime, tregtia juaj do të bekohet pa masë.

Ka njerëz që udhëtojnë për çdo ditë me veturë dhe kur vjen koha e namazit, ata vetëm bëjnë disa lëvizje që ngjajnë në përulje dhe thonë se e falëm namazin, madje nganjëherë nuk e falin fare. Ky është një qëndrim shumë i gabuar. Ata ose duhet të falen para se të nisen, ose të ndalen diku dhe të kryejnë namazin e tyre me koncentrim. Namazi nuk duhet të falet vetëm sa për ta hequr qafesh si obligim. Mesihu i Premtuar^{as} ka thënë se: ***"Namazi juaj nuk duhet t'i ngjajë çukitjes së pulave."***

Tani t'ua hedhim një vështrim udhëtimeve të Mesihut të Premtuar. Sheh Jakub Ali Sahib Irfani^{ra}, transmeton se kur Mesihu i Premtuar^{as} nisej për udhëtim, merrte shumë pak plaçka udhëtimi me vete; pra, vetëm gjërat më të domosdoshme: diçka për t'u mbuluar gjatë natës, ndonjë enë të domosdoshme, disa qirinj dhe ndonjë shkrepës, diçka nga barërat; merrte pastaj penën dhe shishen me ngjyrë. Më vonë kur udhëtonte me familjen e tij, shpesh udhëtonte me tren. Ai udhëtonte me trena të klasit të dytë, madje edhe të klasit të tretë. Arsyeja e vetme për të udhëtuar me trenat e klasit të dytë, ishin tualetet. Zakonisht Mesihu i Premtuar fillonte udhëtimin e tij në mëngjes. Ai nuk dëshironte të nisej në ndonjë udhëtim në pjesën e hershme të natës. Ai thoshte se njeriu duhet të pushojë dhe pastaj të niset në udhëtim. Nuk raportohet të ketë filluar ndonjë udhëtim në pjesën e parë të natës.

Hazret Ebu Umama^{ra}, transmeton se një herë një njeri i tha të Dërguarit të Allahut: "O i Dërguari i Allahut, më lejo të shkoj në një udhëtim vetëm për kënaqësi". Profeti i Shenjtë^{sas} i tha: "Për umetin tim, udhëtimet e ndërmarra për kënaqësi, llogariten si xhihad – përpjekje në rrugën e Allahut".

Këtu pra, na është thënë se qëllimi i udhëtimit tuaj duhet të jetë të fituarit e kënaqësisë së Allahut. Edhe kur të jeni në ndonjë ekskursion, vështroni krijesat e Allahut dhe mendoni për to, dhe ky udhëtim do të ju shtyj në drejtim të Allahut. Xhihadi nuk është vetëm luftë, por është çdo përpjekje që e ndërmerri në rrugën e Allahut. Në ato udhëtime duhet të siguroheni që të mos bëni diçka që do të ju largojë nga Allahu. Secili hap gjatë udhëtimit tuaj duhet të sjellë ndryshim të pastër në veten tuaj. Në kohët tona, xhihadi më i madh për komunitetin e Mesihut të Premtuar, është predikimi. Gjatë udhëtimit tuaj, kërkonit momentet e volitshme për të predikuar. Edhe kur jeni në ndonjë udhëtim biznesi, edhe atëherë, nga mënyra se si ju i lidhni marrëveshjet tuaja dhe si e bëni tregtinë, njerëzit duhet të shohin dëlirësi në ju. Njerëzit duhet ta shohin shpirtin e shenjtë në ju dhe të tërhiqen kah feja juaj – Islami. Nëse udhëtimi juaj është për hir të ndonjë aktiviteti ose tubimi fetar, atëherë ai udhëtim duhet të krijojë një revolucion në karakterin e çdo ahmediani. Këto tubime shpirtërore duhet ta rrisin dashurinë tuaj ndaj Allahut^{xhh}. Dhashtë Allahu që secili ahmedian që vjen në këtë konferencë vjetore, të marrë pjesë me këtë frymë dhe ky tubim të bëhet burim i pafund i bekimeve dhe mëshirës së Allahut dhe ai revolucion shpirtëror të ndodhë në jetën e çdo Ahmediani. Amin!

Në fund, thotë Hazuri, kam një lajm të pikëllueshëm për të gjithë. Hazret Sahibzada Mirza Mubarak Ahmed Sahib, ka vdekur më 21 qershor, në moshën 90 vjeçare. Ina lilahi ve ina ileihi raxhiuun! Kishte lindur më 1914 dhe ishte djali i dytë Kalifit II^{të}, Hazret Musleh Maudh^{ra}. Pas mbarimit të studimeve, e dedikoi jetën e tij në shërbim të Allahut. Ka punuar në Tahrike Jadeed. Pastaj për një kohë të gjatë ka shërbyer me devocion në agrikulturë, në Tabshir, Vakili Ala, ka qenë Sadër Mexhlisi Ansarullah dhe poste të tjera të rëndësishme. Gjatë kalifatit të katërt, ka qenë kryesues i shumë organizmave në Xhematë. Ai ka dy djem dhe një vajzë. Vajza e tij jeton në Kanada. Djali i tij, Dr. Khalid Tasnim Sahib është në Rabvah këto ditë dhe është duke i shërbyer Xhematit atje. Djali i tij i madh është Mirza Muxhib Ahmed Sahib. I ndjeri ka qenë daja im. Hazuri tha se pas namazit të xhumasë, do t'ia falim namazin e xhenazes në mungesë, insha'allah!

Note: This is an Albanian translation of Hazoor's Khutba of: **25 June 2004**

The topic of this Khutba is: **'The Journey'**

This translation has been prepared by the members of Kosovo Jam'at